

Janë me mijëra raste, kur "doktorë popullor" pa asnjë ditë shkollë ia kanë dalë të shërojnë të sëmurët, qoftë edhe përkohësisht. "Nuk zgjasim jetë njerëzish por i shërojmë pacientët për të cilët spitalet nuk kanë ilaç", rrëfen një mjekë popullore nga Shtipi, e cila më tepër se 20 vite përgatitën ilaç për të sëmurët me kancer. Biljana Petrevska nga Shkupi tregon se nëna e saj ka 10 vjet që e sfidon kancerin me shurupin e "doktoreshë" Gordanës

Laura PAPANIKU

Njerëzit me fuqi të "mbinatyrshe" të cilët ofrojnë shërbime të ndryshme mjekësore vazhdojnë të jenë ende në "modë" në gjithë Maqedoninë. Janë me qindra persona të këtyrë të cilët preferojnë të quajnë veten doktorë popullor dhe që veprojnë nëpër ordinancat e improvizuara të tyre pa u ngacmuar prej askujt dhe kuptohet të motivuar financiarisht nga klientët në numër relativisht të madhe. Edhe pse vërojnë në kundërshtim me ligjin, i cili nuk e pranon veprimin alternativ të shërbimeve mjekësore jashtë institucioneve të licensuara shëndetësore, doktorët popullorë operojnë me shumë sukses në thuasje të gjitha shtresat e shoqërisë, pa dallim moshe, përkatësi etnike, fetare apo shkallë të arsimimit.

Doktorët edhe mjekët specialist preferojnë të minimizojnë rolin e mjekëve popullor duke thënë se "pacientët e tyre janë kryesisht persona të pa shkolluar sa duhet", mirëpo në praktikë është e pamundur të bësh një klasifikim të prerë apo kategorizim të pacientëve të tyre, pasi shërim prej doktorëve popullorë kërkojnë burra dhe gra, të shkolluar dhe të paarsimuar, fëmijë, të rinj dhe të moshuar. "Çudi bërjen" e tyre mjekët dhe specialistët e lidhin me sugestionizmin e pacientëve dhe me ndikimin momental që ka besimi në ndryshimin e gjendjes shpirtërore dhe për pasojë edhe të gjendjes fizike. Mirëpo, në këtë veprimtari të mjekësisë alternative janë infiltruar edhe shumë mashtrues të cilët përforcojnë ende më tepër tezën se mjekësia nuk mund të bëhet në përshkrim dhe në kushte primitive.

"Shërimi" i kancerit me mjaltë dhe verë

Pa asnjë ditë shkollë, doktorët popullorë e kanë shndërruar në zanat mjekësinë, kurse disa kanë fituar aq famë, sa për suksesin që kanë pasur me pacientët e tyre janë të njohur jo vetëm në qytetin ku veprojnë por edhe më gjerë. Kështu, në qytetin lindor të Maqedonisë, Shtipi, Gordana M. përgatitën shurup kundër kancerit.

Biljana Petrevska, nga Shkupi, tregon se nëna e

Hulumtim mbi doktorët që veprojnë jashtë spitaleve (2)

Mjekësia popullore, mes alternativës dhe mashtrimit



saj ka 10 vjet që po sfidon kancerin me shurupin e "doktoreshë" Gordanës. "Shurupi është një përzjerje që ndihmon në frenimin e sëmundjes dhe shërimin e saj pasi shkatërron qelizat kancerogjene. Duke përmbytur lëndë të shëndetshme: mjaltë, verë, një lloj kafe special e bardhë dhe një lloj lule nga lloji i bimëve alovera. Ilaçi rritet imunitetin e të sëmurit dhe në këtë mënyrë del fitues mbi sëmundjen", tregon Gordana. Profesioni e doktorit popullor, thotë se e trashëgon nga vjehrra e saj, Kalinka, që gjithashtu ka qenë e njohur në përgatitjen e barërave për sëmundje të ndryshme malinje. "Neve nuk zgjasim jetë njerëzish pasi kjo është në dorën e Zotit por vetëm shërojmë. Pasi ekziston diçka, që shkakton sëmundjet duhet të ekzistojë edhe ilaçi që e shkatërron shkaktarin në fjalë", komenton "doktoresha", ndërsa pohon se përgatitjen me qindra shishe ilaç në vit për pacientë nga gjithë Maqedonia.

"Vijnë edhe shqiptarë, turq dhe boshnjakë e jo vetëm maqedonas", tregon 47 vjeçarja nga Shtipi, Gordana M, e cila ka 20 vjet që merret me këtë punë. Para se ti përkushtohet profesionit të "doktorit", ajo kishte punuar shitëse në një dyqan bukësh. "Kur vjehra, tani e ndërë, hyri në moshë, kishte nevojë për asistencë pasi nuk ia dilte tu përgjigjet të gjitha kërkesave. Vendosa ta lë punën në dyqan që ti ndihmoj asaj. Në fillim nuk doja të lidhem me këtë profesion por e bëra për hir të atyre njerëzve të cilët vinin të kërkojnë shërim këtu".

"Out" ligjit

Për mjekët dhe specialistet e Institutit të radioterapisë dhe onkologjisë, në Shkup, është totalisht e papranueshme terapia e

shërimin të kancerit me barëra popullore. Bile nuk duan të prononcohen për "përralla të këtyrë" sikurse i quajnë historitë e shërimin me barna popullore. "Nuk është aq e lehtë. Kanceri është sëmundje që vepron në organet brenda trupit të njeriut dhe është naivë të thuhet se mund të shërohet me mjaltë dhe verë. Mjalti dhe vera, në ndonjë rast, mund të risin fuqinë fizike të sëmurit por jo edhe të shërojnë sëmundjen. Ndryshe, nuk kishte pse të përdorim terapi me preparate mjekësore dhe të shpenzoheshin me qindra mijëra euro për aparatet, kur me ato pare mund të blinin fuqi pa fund me verë dhe mjaltë dhe kështu të shëronim të gjithë të sëmurët", përgjigjen specialistët e onkologjisë. Sipas, prof.dr. Radmilla Manevska, ajo që për momentin mund të mashtrujnë të sëmurët apo të afërmit e tyre është ndikimi i vetëbesimit të pacientit mbi sëmundjen. "Fuqia e besimit, si gjendje psikike, tek disa pacientë ndikon që ta përballojnë më lehtë sëmundjen, por kurrsesi ta shërojë atë". "Doktoresha" Gordana, pranon faktin se pacientët e saj janë kryesisht në gjendje të rëndë shpirtërore dhe gjendje të luhatshme psikike. "Pacientët, vijnë këtu me shpresën e humbur prej spitaleve. Vijnë të dobësuar dhe të thyer shpirtërisht. Unë e kuptoj se ilaçi ka dhenë efekt kur pacientet e njëjtë vijnë të bëjnë porositë e radhës. Kjo është satisfakcioni më i madh për mua" shpjegon ajo, ndërsa thotë se porositë e pacientëve të njëjtë zgjasin nga dy, tri, katër deri edhe dhjetë vjet. Në Maqedoni nuk është e rregulluar me Ligj veprimtaria e mjekëve popullor. Ka pasur iniciativa që puna e tyre të inkorporohet në sistemin ligjor shëndetësor, mirëpo për shkak të infiltrimit të mashtruesve në këtë

mes, mbeti pa u rregulluar edhe statuti i mjekëve të mirëfilltë popullor. "Nuk mund të japin prova dhe garanci se shërojnë me terapi të tyre - në radhë të parë dhe në radhë të dytë duhet që vetë ata që shërojnë me ilaçe popullore, duhet të gjejnë mekanizëm se si krijojnë murin ndarës mes 'të vërtetëve' dhe 'mashtruesve'".

Denoncimi

Në Ministrinë e Shëndetësisë, nuk kanë të dhëna se sa mund të jetë numri i mjekëve popullor, qofshin të "vërtetëve" apo mashtrues. "Me veprimtarinë e paligjshme, duhet të merren organet tjera kompetente", thonë nga shërbimi për informim.

Në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërkaq thonë se nuk mund ti identifikojnë të gjithë mjekët popullor, pasi MPB-ja mundet të veprojë vetëm në bazë të rasteve të paraqitura për mashtrim apo keqpërdorim. "Në periudhën prej vitit 2000 deri në 2010 MPB-ja ka përgatitur padi penale për gjithsej shtatë 'mjekë popullor', prej të cilëve dy vepra janë regjistruar në vitin 2003, katër në 2005-ën dhe një në vitin 2008", bën të ditur ndihmësministri Ivo Kotevski. Sipas qyteteve, tre vepra thotë se janë regjistruar në rajonin e Ohrit, dy në të Strumicës dhe nga një në Manastir dhe Shtip. Të gjitha rastet kanë të bëjnë me mashtrues, të cilët për shërbimin e premtuar kanë marrë fillimisht shumë të majme të hollash dhe kur "pacientët" nuk kanë vërejtur asnjë ndryshim i kanë denoncuar më pas në polici "mjekët mashtrues". Inspektorët e MPB-së, thonë se në Maqedoni duhet të jetë shumëfish më i madh numri i të ashtuquajturve "doktorë popullor" mirëpo problemi është se qytetarët nuk tregohen të gatshëm

të bashkëpunojnë me policinë për zbulimin e tyre. Kështu, në rajonin e Tetovës dhe Gostivarit, me petkun e hoxhës kamuflonjë shumë individë të cilët pretendojnë se "largojnë magjitë" apo shërojnë "njerëzit e zaptuar prej xhindev". Edhe në qytetin e Ohrit, i gjen shumë të këtyrë, që "shërojnë" me kryqe dhe ikona dhe që për "të larguar të keqen" të dërgojnë të mbushësh ujë në shtatë çezma, duke të preferuar të lashë nga një dhuratë në secilën prej tyre.

Shërimi spiritual

"Pope Risto", sikurse njihet njëri, me vendbanim në Ohër, gjatë "terapisë" të shtytin të shkruash me dorën tënde leksionet dhe në këtë plan ti cakton edhe ditët dhe radhën e çezmave të burimeve nga duhet nisur me grumbullimin e ujit dhe dërgimin e dhuratave. Në rrethin e Shkupit, nuk ka fshat pa një "mulla" (një titull fetar ky) të cilët me libra dhe fletore në kopertina të vjetra bëjnë sikur shërojnë. Në fshatin Lubin, të Shkupit, i ashtuquajtur "Mullai i fshatit", pretendon se është më i miri i rajonit. Ai, ka studiuar në shtetet arabe dhe këtë fakt ka arritur ta materializojë mjaft mirë, duke i shtuar kredi vetes. Thotë se ushtron një "profesionit human" edhe pse nuk i refuzon asnjëherë paratë që i jepen. "Janë disa sëmundje që nuk i shëron dot mjekësia e asnjë bote. Këto janë sëmundjet e shpirtit. Doktorët e spitaleve, mund të shërojnë sëmundjet e trupit (edhe ato jo të gjitha fatkeqësisht), mirëpo nuk mundet të shërojnë sëmundje të shpirtit, sepse nuk ka mjet me se ta bëjë këtë. Trupi, organet e tij janë materie të prekshme dhe kur ato sëmurin intervenohet me mjete. Mirëpo kur është në pyetje shpirti ata edhe po të duan nuk kanë mjete me se të intervenojnë",

sqaron "Mullai i fshatit", i cili pretendon se zotëron dijen për të shëruar me intervenime "spirituale" në shërimin e sëmundjeve të shpirtit.

Krimba nga sytë?!

Në mesin e specialiteve të çuditshme të mjekimit popullor është edhe "nxjerrja" e krimbave nga sytë dhe veshët, sidomos tek fëmijët. Këtë çudi, ka mbi 40 vjet që e ushtrojnë publikisht dy gra romë në Dibër. Mjekët të quajnë injorant nëse i beson kësaj historie "banale dhe trishtueshme", sipas tyre. Mirëpo "e bukura", siaps nënave është se pasi fëmijëve u janë nxjerrë krimbat, ato, flenë të qetë të paktën një javë. Mjeti i vetëm i këtij "shërimi" është një stilolaps, ana e ngushtë e së cilës afrohet te maja e syrit (lig. medialis palpebrales) ose te e çara e veshit te pjesa që me gjuhën e mjekësisë njihet si Meatus acusticus exterus. "Nusja e Zenes", sikurse quhet gruaja që me shumë sukses u nxjerrën krimba jo vetëm fëmijëve të këtij qyteti por nga shumë vende të tjera, nuk ia ka idenë se si quhen me mjekësi vendet nga i nxjerrën krimbat. "Zanatin ma la vjehrra" pohon ajo, duke treguar stilolapsin e bardhë dhe "grumbullin e krimbave" që sapo i kishte nxjerr një fëmijë 7 muajsh. E ëma e foshnjës, Safia një 37 vjeçare tregon se vjen shpesh këtu, gati çdo javë, kurse paguan nga 10 denarë për një krimb të nxjerrë. "Një herë i nxori dy krimba edhe nga syri i majtë, ndërsa gjithë kohës vajzës i nxjerrim krimba prej veshëve, nga shtat-tetë, ndonjëherë edhe më shumë". Ajo, tregon se e kam pasur vajzën te mjeku fillimisht. "Nuk mund ti bënin asgjë për t'ia ndaluar të qarën. Prandaj, ju këtu sepse këtu e kam gjetur ilaçin, tregon Safia. Beson në vërtetësinë e zanatit të "mjekes", sepse sa herë i nxjerrën krimba, vajza qetësohet. "Do të fle e qetë si qengi, të paktën 5 ditë e ndoshta edhe 10, kurse para se ta sjell këtu kishte dy ditë që vajza qante dhe mbante duart te veshët, duke i kruar ato".

"Kam dëgjuar për këtë, prej njerëzve që kanë shkruar vetë apo u kanë nxjerr fëmijëve krimba nga veshët apo nga sytë. Kam dëgjuar të tregojnë se i kanë nxjerrë 10 apo 20 krimba. Ç'të them. Unë personalisht nuk e besoj këtë. Sepse pikë së pari nuk ka vend se ku të rinë aq shumë krimba në një vend, në boshllëkun e syrit, apo në vesh. Nuk u besoj këtyre gjërave, sepse nuk ka mundësi të vërtetohen shkencërisht", komenton dr. Shkëlqim Sela - psikiatër. Sela, i cili punon doktor psikiatër në qendrën spitalore të Dibërës, dukurit e këtyrë i shpjegon me paranojat dhe neurozat e njerëzve, të cilët, thotë se kanë dëshirë të besojnë në diçka, pra kanë fiksime. (fund)

Ky hulumtim është bërë në bashkëpunim me organizatën daneze të gazetarisë hulumtuese SCOOP